

**SHARING STORIES.**  
**SHAPING THE FUTURE:**  
**DIALOGUES FOR SPACE**

REPORT FOR WORKSHOP III  
18 - 20 DECEMBER 2014

**SHKËMBEJMË PËRVOJAT.**  
**FORMËSOJMË TË ARDHMEN:**  
**DIALOGJET PËR SPAÇIN**

RAPORT I PUNËTORISË III  
18 - 20 DHJETOR 2014



# CONTENTS

# PERMBAJTJE

Executive summary	3	Përmbledhje ekzekutive
Introduction	4	Hyrje
Workshop agenda	8	Axhenda e realizuar
List of participants	9	Lista e pjesëmarrëve
Current situation of Communist-era heritage in Albania	12	Aktualiteti i trashëgimisë së periudhës së komunizmit
Action plan	12	Plan-veprimi
	14	Tabela e plan-veprimit (shqip)
The action plan table (English)	22	
List of acronyms	30	Lista e akronimeve të përdorura
Next steps	31	Hapat e mëtejshëm
Visits around Gjirokastra	32	Vizita në Gjirokastër
Evaluation of the workshop	34	Vlerësimi i punëtorisë
Further information	39	Informacione të mëtejshme

# EXECUTIVE SUMMARY

## PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

While there should exist a consensus among institutions, citizens and civil society that Spaç can and should be a place to document and confront the macabre abuses of the Communist period, very little has been said until today about the way that Spaç can be turned into a contemporary museum.

A careful and realistic approach is needed in order to turn this former prison into a museum. The formulation of this approach is the goal of the project "Sharing Stories, Shaping the Future: Dialogues for Spaç," currently being implemented by Cultural Heritage without Borders (CHwB) with support from the International Coalition of Sites of Conscience.

Based on a participation-focused methodology, a large spectrum of stakeholders and through a series of three workshops of several days, a summary of the existing knowledge about Spaç was completed, as well as the definition of the vision and related objectives that will lead its becoming a museum. The last workshop, which was held in Gjirokastra, was aimed at the definition of the concrete steps towards the making of a museum in Spaç. Thus, based on the findings of the first two workshops in Mirdita and Shkodra, the participants formulated a detailed action plan that includes the explanation of each activity, the shared responsibilities among the stakeholders, the indicative deadlines for the completion of each activity, as well as potential sources of funding.

The action plan will be submitted to a public consultation process, the details of which are currently being discussed among the involved stakeholders.

The action plan will not only serve as a guideline, but it will be used by the stakeholders as a catalogue of actions/projects/initiatives agreed upon multilaterally, which is aimed at securing national and international support for the preservation and promotion of Spaç prison.

Ndërsa duket të ekzistojë një konsensus mes institucioneve, qytetarëve dhe shoqërisë civile, që Spaçi mund dhe duhet të jetë vendi i dokumentimit dhe i përballjes me abuzimet makabre të periudhës së Komunizmit, pak është folur deri më sot për mënyrën se si mund të kthehet ai në një muze bashkëkohor.

Përfaqsjë e kujdesshme dhe realiste ndaj muzealizimit të ish-burgut të Spaçit, është synimi i projektit «Shkëmbejmë Përvojat, Formësojmë të Ardhmen: Dialogjet për Spaçin» që zbatohet aktualisht nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), me mbështetjen e Koalicionit Ndërkombëtar të Vendeve të Ndërgjegjes.

Në sajë të një metodologjite përfshirëse dhe së bashku me një spektër të gjerë aktorësh u bë i mundur, në kuadër të një serie prej tre punëtorish disaditore, një rikapitullim i njohurive të deritanishme dhe përcaktimi i vizionit dhe i objektivave që do ti prijnë muzealizimit të Spaçit. Punëtorja e fundit, e mbajtur në Gjirokastër, kishte për qëllim përcaktimin e hapave konkretë që duhen të ndërmerren për të bërë realitet muzealizimin e ish-burgut. Kështu duke u bazuar në gjetjet e dy punëtorive të para në Mirditë dhe në Shkodër, pjesëmarrësit formuluan një plan të detajuar veprimi që përfshin përshkrimin e veprimeve, ndarjen e përgjegjësive mes palëve të interesit, afatet paraprake të realizimit si dhe burimet e mundshme të financimit.

Plani-veprimi, do ti nënshtrohet dhe një shqyrtimi publik, modalitet e secilit janë duke u diskutuar aktualisht mes palëve të përfshira.

Plan-veprimi, përpos karakterit udhërrëfyes që mbart, do të përdoret nga palët e interesuara dhe si një katalog aktivitetesh/projektsh/nismash të dakorduar nga shumë palë, me qëllim sigurimin e mbështetjes në nivel kombëtar por dhe ndërkombëtarisht për ruajtjen dhe promovimin e ish-burgut të Spaçit.

# INTRODUCTION

# HYRJJE

## Background

A number of the political prisoners who were taken to Spaç prison were artists, writers and other intellectuals, many of whom have spoken out about their experience in recent years. This has helped to make Spaç one of the most symbolic sites for the horror of persecution under the Communist regime, as well as perhaps the site that is most present in the collective memory of Albanians. As such, the primary value of Spaç today is as a much-needed place of memory for the crimes of the Communist regime—a physical space to 'locate' and address the traumas of that past, both for the former political prisoners who suffered there and for the rest of the Albanian people. Such sites of memory can represent not only the trauma of that period, but also resistance to and, ultimately, the downfall of the former regime.

Today, there seems to be a growing consensus among institutions, citizens and civil society actors that Spaç could and should serve as a place for documenting and confronting the abuses of human rights that occurred under the Communist regime. In addition, this site will be an important means of teaching Albanians and foreigners about this difficult period of history in a deep, experiential way. This comes at a time when tourism demand for former Communist sites is on the rise, potentially creating a much-needed economic opportunity for the local community, which is suffering from chronic poverty and steady emigration.

Finally, the success of Spaç in dealing with this specific type of heritage would make it possible to form a contemporary approach to revitalizing the sites of persecution in Albania, hoping that after Spaç, the same process could be undertaken for Qafë Bari, Bënça and so on with many more sites of conscience.

## Prapavija

Spaç është një nga vendet emblematike të tmerrit të persekutimit Komunist dhe ndoshta vendi që më së shumti është i pranishëm në kujtesën kolektive të Shqiptarëve. Si i tillë, vlera parësore e tij sot është identifikimi nga të gjithë si vend shumë i nevojshëm i kujtesës së krimeve të regjimit Komunist – një vend fizik, ku jo vetëm ish të përndjekurit politikë por e tërë shoqëria, mishëron e shëron traumat e së kaluarës Komuniste. Të tillë vende të kujtesës mund të përfaqësojnë jo vetëm traumat e kësaj periudhe por gjithashtu rezistencën ndaj regjimit si dhe rënien e tij.

Duket të ekzistojë një lloj konsensusi i përgjithshëm mes institucioneve, qytetarëve dhe shoqërisë civile, që Spaçi mund dhe duhet të jetë vendi i dokumentimit dhe i përballjes me abuzimet makabre ndaj të drejtave themelore të njeriut të kryera gjatë regjimit Komunist. Një vend i të tillë do të kishte dhe një dimension të rëndësishëm edukativ e arsimor që do të mundësonte, për Shqiptarë e të huaj, një përvojë të plotë dhe të prekshme për këtë periudhë të vështirë historike. Ky vizion përputhet gjithashtu me tendencat në rritje të turizmit në/për vendet e Komunizmit, çka do të gjeneronte mundësi jetike zhvillimi ekonomik për bashkësinë lokale që vuan prej kohësh nga varfëria dhe emigracioni.

Së fundmi Spaçi si model i mirë i trajtimit të kësaj trashëgimie specifike do të formësonte një përfaqje dhe një përvojë bashkëkohore të revitalizimit të vendeve të persekutimit, duke shpresuar që pas Spaçit t'u vijë rradha dhe Qafë-Barit, dhe Bënçës, e shumë vendeve të tjerë të ndërgjegjes.



Fig. 1: The discussion about Communist-era heritage today.

Fig. 1: Diskutime mbi trajtimin e trashëgiminë komuniste sot.

## The Dialogues for Spaç project

In 2014, Cultural Heritage without Borders (CHwB) began implementation of the project “Sharing Stories, Shaping the Future: Dialogues for Spaç”, with the support of the International Coalition of Sites of Conscience.

This project included a series of three workshops, which were held successfully over the course of the year:

- Workshop I, held June 12 – 14, 2014 in Mirdita, aimed to deepen our knowledge about Spaç and familiarize all of the participants about the primary issues and understandings surrounding the site.
- Workshop II, held October 30 – November 1, 2014 in Shkodra, was built around values, various case studies and primary objectives, which should guide the creation of a museum at the former prison.
- Workshop III, held December 18 – 20, 2014 in Gjirokastra, concluded the whole process with the an attractive and qualitative action plan, intended to bring to life the proposals and thoughts expressed during the project activities.

An essential part of this project is the creation of a common space for dialogue among individual and institutional voices. Each has its own history; its own experiences related to Spaç; its own point of view on

## Projekti i Dialogjeve për Spaçin

Gjatë vitit 2014, CHwB ka filluar zbatimin e projektit “Shkëmbejmë Përvojat, Formësojmë të Ardhmen: Dialogjet për Spaçin”, me mbështetjen e International Coalition of Sites of Conscience.

Projekti synonte organizimin e një serie prej 3 punëtorish, të mbajtura me sukses gjatë vitit:

- Punëtorja I, e mbajtur më datat 12-14 Qershor 2014 në Mirditë, kishte si synim thellimin e njohurive për Spaçin dhe familjarizimin e të gjithë pjesëmarrësve me problematikat dhe kuptimet kryesore të Spaçit.
- Punëtorja II, e mbajtur në datat 30 Tetor – 1 Nëntor 2014 në Shkodër, u ndërtua rreth vlerave, shembujve të ndryshëm dhe objektivat kryesorë që duhet të prijnë kthimin në muze të ish-burgut të Spaçit.
- Punëtorja III, e mbajtur në datat 18 – 20 Dhjetor 2014 në Gjirokastrë, kishte për synim kurorëzimin e procesit me përgatitjen një plan-veprimi konkret, cilësor dhe ndjellës për ti dhënë jetë propozimeve dhe mendimeve të shprehura gjatë gjithë procesit.

Pjesëthelbësore e këtij projekti është krijimi i një hapësire të përbashkët për dialog mes zërave institucionalë dhe individualë që kanë historitë, përvojat e tyre në lidhje me Spaçin, pikëpamjet e tyre - jo domosdoshmërisht të njëjta – mbi kuptimin dhe vlerat e këtij vendi simbol të

the meaning and value of this site that symbolizes the repressive Communist system and, therefore, different expectations about its future.

sistemit represiv Komunist, e për rrjedhojë, pritshtëri të ndryshme për të ardhmen e tij.

The chart below outlines the main steps in the project:

Skema e projektit (më poshtë) përmbledh hapat kryesorë të projektit:




Fig. 2: Skema e projektit




Fig. 3: Project scheme



## Workshop III objectives

After workshop I, which was focused on creating/reinforcing a base of knowledge on Spaç and getting to know its main issues, and workshop II where clear objectives were defined for the site, the main goal of workshop III was the compilation of an action plan for Spaç. The common work of the participants was to break down the 3 defined objectives into concrete actions. Those present split into 3 working groups (one for each objective), based on each person's professional profile or related to the institution they represent, in order to be able to discuss proposals from different professional, personal or institutional points of view. The content of the action plan table was compiled and then discussed with everyone during a common session. At the end of the workshop, the results were completed and integrated by CHwB in accordance with the workshop discussions.

## Objektivat e punëtorisë III

Pas punëtorisë I që ishte e fokusuar në krijimin/forcimin e një bagazhi njohurish për Spaçin dhe njohjen me problematikat e tij kryesore, dhe punëtorisë II ku u përcaktuan objektiva të qarta për muzealizimin e tij, hartimi i planit të veprimit ishte qëllimi kryesor i punëtorisë III. Puna e përbashkët konsistoi në zbërthimin e tre objektivave të përcaktuar në aksione konkrete nga pjesëmarrësit. Ata u ndanë në tre grupe sipas objektivave, duke u bazuar në profilin e tyre apo sipas institucionit që përfaqësojnë, për të mundësuar kështu diskutimin e propozimeve nga këndvështrime të ndryshme personale, profesionale apo institucionale.

Përmbajtja e tabelës së planit të veprimit u përpilua dhe më pas u diskutua nga të gjithë grupet në një sesion të përbashkët. Pas përfundimit të punëtorisë, rezultatet u plotësuan dhe u harmonizuan nga CHwB në përputhje me diskutimet e zhvilluara gjatë punëtorisë.



Fig. 4: Within the abandoned, almost-destroyed space of the former prison camp at Bënça, near Tepelena.

Fig. 4: Në brendësi të hapësirës së braktisur dhe pothuajse të rrënuar të ish-burgut të Bënçës, afër Tepelenës.

# WORKSHOP AGENDA

## AXHENDA E REALIZUAR

### DAY 1 | THURSDAY, DECEMBER 18

- 08:00 Participants from Shkodra, Reps and Tirana meet and depart for Gjirokastra
- 12:30 Arrival and accommodation in Gjirokastra
- 13:00 Lunch
- 14:00 **Group visit:** Nuclear defense tunnel and '7 windows' prison in the castle
- 19:00 Dinner

### DAY 2 | FRIDAY, DECEMBER 19

- 09:00 Welcome, goals and methodology for workshop III
- Presentation and joint discussion:** Current situation with Communist-era heritage
- 10:30 Coffee break
- 11:00 **Presentation:** Methodology for filling out the Action Plan
- Group work:** Filling out the Action Plan
- 12:30 Lunch
- 14:00 **Group work:** Filling out the Action Plan
- 15:30 Coffee break

### DITA 1 | E ENJTE, 18 DHJETOR

- 08:00 Grumbullimi i pjesëmarrësve nga Shkodra, Repsi dhe Tirana; nisja për në Gjirokastrë
- 12:30 Mbërritja dhe akomodimi në Gjirokastrë
- 13:00 Dreka
- 14:00 **Vizitë në grup:** Tuneli antibërthamor dhe burgu i '7 penxhereve' në kala
- 19:00 Darka

### DITA 2 | E PREMTE, 19 DHJETOR

- 09:00 Mirëseardhja, qëllimi dhe metodologjia e punëtorisë III
- Prezantim dhe diskutim i përbashkët:** Aktualiteti i trashëgimisë së periudhës së komunizmit
- 10:30 Pushim për kafe
- 11:00 **Prezantim:** Metodologjia e hartimit të Plan-veprimit
- Punë në grup:** Përpilimi i Plan-veprimit
- 12:30 Dreka
- 14:00 **Punë në grup:** Përpilimi i Plan-veprimit
- 15:30 Pushim për kafe



- 16:00 Presentation and joint discussion about the Action Plan
- 17:00 Evaluation of the workshop by participants
- 20:00 Dinner

**DAY 3 | SATURDAY, DECEMBER 20**

- 09:00 Departure for a visit to cultural heritage sites around Gjirokastra
- Departure for Tirana
- Lunch

- 16:00 Prezantim dhe diskutim i përbashkët i Plan-veprimit
- 17:00 Vlerësimi i punëtorisë nga pjesëmarrësit
- 20:00 Darka

**DITA 3 | E SHTUNË, 20 DHJETOR**

- 09:00 Nisja për vizitën e organizuar në vendet e trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës
- Nisja për në Tiranë
- Dreka



Fig. 5: Inside the anti-nuclear tunnel of Gjirokastra, exploring the few remained objects.

Fig. 5: Në brendësi të tunelit anti-bërthamor të Gjirokastrës duke eksploruar objektet e pakta të mbetura.

# LIST OF PARTICIPANTS

## LISTA E PJESEMARRRESVE

NR.	NAME   EMËR	INSTITUTION / ORGANIZATION	INSTITUCIONI / ORGANIZATA
1.	Gjetë Gjoni	Spaç prison caretaker, local resident	Kujdestar i burgut të Spaçit, Banor vendas
2.	Bilal Kola	Institute for the Integration of the Former Politically Persecuted, Director	Instituti për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, Drejtor
3.	Marsela Karpuzi	Ministry of Urban Development and Tourism; Directorate of Territorial Control, Standards and Anti-Corruption; Sector for Control of Urban and Tourist Zones and Implementation of Priorities; Sector Head	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit; Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Standarteve dhe Antikorrupsionit; Sektori i Kontrollit të Zhvillimit Urban e Zonave Turistike dhe Jetësimin të Prioriteteve; Përgjegjëse
4.	Tea Çuni	Place of Witness and Memory – Shkodër; museological specialist	Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës – Shkodër; specialiste muzeologe
5.	Zenel Drangu	Former political prisoner in Spaç, Head of the Association of Former Politically Persecuted People, Shkodër branch	Ish i burgosur politik në Spaç; Kryetar i Shoqatës së ish të Përndjekurve Politikë, dega Shkodër
6.	Majk Mila	“Spaç Prison Museum” Association, staff	Shoqata “Muzeumi Burgu i Spaçit”, punonjës
7.	Vladimir Banushi	“Spaç Prison Museum” Association, Project Assistant	Shoqata “Muzeumi Burgu i Spaçit” Asistent Projekti
8.	Dafne Bajraktari	University of Tirana, Faculty of History & Philology, Journalism Dept., Student	UT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Dpt i Gazetarisë, Studente
9.	Nedina Dajko	University of Tirana, Faculty of History & Philology, Journalism Dept., Student	UT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Dpt i Gazetarisë, Studente
10.	Magdalena Margariti	Regional Directorate of National Culture– Gjirokastra, Specialist	Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrë, Specialiste
11.	Genc Bejleri	Ministry of Culture, Directorate of Cultural Heritage, Sector Head	Ministria e Kulturës, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Përgjegjës sektori

12.	Matthias Bickert	Cultural Heritage without Borders (CHwB), Program Coordinator	Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Koordinator programi
13.	Nedi Petri	Cultural Heritage without Borders (CHwB), Project Assistant	Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Asistent projekti
14.	Mirian Bllaci	Cultural Heritage without Borders (CHwB), Project Manager	Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Menaxher projekti

*Also present during part of the working sessions were:*

*Të pranishëm gjatë sesioneve të punës ishin dhe:*

15.	Arjan Aurazi	Ministry of Culture, Sector Head	Ministria e Kulturës, Përgjegjës sektori
16.	Gëzim Halili	Ministry of Culture, Specialist	Ministria e Kulturës, Specialist
17.	Meri Kumbe	National Center for Folk Activities, Director	Qendra Kombëtare e Veprimtarisë Folklorike, Drejtoreshë



Fig. 6 & 7: Moments during the drafting of the action plan.



Fig. 6 & 7: Momente nga hartimi i plan-veprimit.

# THE WORKING PROCESS PROCESI PUNES

## The current situation with Communist-era heritage

The theoretical part of the workshop was launched the second day with a group discussion about the 2014 developments related to Communist-era built heritage in Albania. The discussion embraced aspects like: the concepts chosen for reuse some of the places of this heritage (through art, culture, commemorative activities, real or virtual spaces etc.); the relationship between center and periphery and the institutional actors; the communication about the activities; the relationship between authenticity and reconstruction or recreation of objects and the impact they have; the public perception of this kind of heritage; the experiences offered to the visitors based on the selected museum concepts; etc.

The different examples were seen through a critical filter, showing the positive and negative aspects of those initiatives, which remain useful experiences for the possible future 'musealization' of Spaç.

## Action plan

The details reflected in the action plan table (pages 22-29) come from the previous knowledge and experience of the workshop participants and from their realistic assessment of the roles and responsibilities of each stakeholder. The proposals were developed with the intent of including those stakeholders not present at the workshop, in order to identify all the actors who could successfully implement each proposal.

In cases where an action is marked with more than one actor, it could be undertaken in cooperation, according to the institutional roles and competencies or strategies of each.

## Aktualiteti i trashëgimisë së periudhës së komunizmit

Pjesa teorike e punëtorisë u çel ditën e dytë me një diskutim të përbashkët rreth zhvillimeve gjatë vitit 2014, në lidhje me trashëgiminë e ndërtuar të periudhës së komunizmit. Diskutimi përfshiu aspekte të tilla si: koncepti i përzgjedhur për ripërdorimin e disa prej vendeve të kësaj trashëgimie (përmes artit, kulturës, aktiviteteve përkujtimore, hapësirave reale ose virtuale etj.), marrëdhëniet qendër-periferi dhe ato ndërinstitucionale, komunikimi rreth aktiviteteve të propozuara, raporti mes autenticitetit dhe rikonstruksionit ose rikrijimit të objekteve dhe atmosferës që përçojnë, perceptimin nga opinioni publik i vendeve të kësaj trashëgimie, përvojat që u ofrohen vizitorëve në bazë të koncepteve të përzgjedhura të muzealizimit, etj.

Shembujt e ndryshëm u panë nëpërmjet një filtri kritik mbi aspektet pozitive dhe negative të këtyre nismave, të cilat ngelen përvoja të dobishme për mundësitë që ofron muzealizimi i ardhshëm i ish-burgut të Spaçit.

## Plan-veprimi

Të dhënat e paraqitura në tabelën e planit të veprimit (faqe 14-21) vijnë nga përvojat dhe njohuritë e mëparshme të pjesëmarrësve dhe nga parashikimet e tyre realiste për rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë të interesit. Propozimet dhe diskutimet janë zhvilluar në një frymë përfshirjeje dhe të palëve jo të pranishme në punëtori, duke u mbështetur në parimin e identifikimit të aktorëve që mund të ndërmarrin me sukses realizimin e çdo propozimi.

Në rastet kur në qelizat e tabelës është shënuar më shumë se një palë, veprimi mund të kryhet në bashkëpunim, sipas kompetencave dhe roleve institucionale apo strategjive dhe mundësive të secilës strukturë/institucion të identifikuar.

Part of the discussions for the action plan involved also defining the approximate costs for each possible action/activity/project. But, from these discussions it was decided that foreseeing costs in this phase would be not realistic. A more detailed cost analysis would be necessary case by case, for each initiative.

The action plan table is divided into six columns, which are respectively:

### **Action/Activity/Project**

The description of actions to be undertaken for the realization of the pertinent objectives. Their formulation is done according the SMART criteria (specific, measurable, achievable, realistic, time bound) to be as operational as possible.

### **Initiator**

The institution/entity/organization/person who undertakes the start of the proposed action/activity/project.

### **Implementor**

The institution/entity/organization that ensures the successful implementation of the proposed initiative. This is about the actors that will ensure the good administration of the proposed initiative, while the professional responsibility should be defined case by case in further detail.

### **Supervisor**

The institution/entity/organization that supervises the successful implementing of the initiative proposed. Supervising, in relation to this action plan includes public institutions as well as civil society.

### **Time frame**

The time limits within which the proposals could be implemented; they could be: short term (1-3 years), mid term (4 – 6 years) and long term (> 6 years).

### **Funding sources**

The different funding possibilities for the proposed initiatives, like for example, entity/state grants, national/foreign businesses or donors. This column is based on the previous experiences of the participants and further research from CHwB.

Pjesë e diskutimeve për plan-veprimin ishte dhe përcaktimi i kostove të përafërta për secilin aksion/aktivitet/projekt të mundshëm. Por u arrit në konkluzionin që në këtë fazë të detajimit, parashikimi i kostove do ishte larg realitetit. Shqyrtimi më i detajuar dhe rast pas rasti në të ardhmen mbetet i nevojshëm.

Tabela e planit të veprimit është e ndarë në 6 kolona, të cilat janë përkatësisht:

### **Aksioni/Aktiviteti/Projekti**

Përshkrimi i veprimeve që duhen ndërmarrë për realizimin e objektivave përkatës. Formulimi i tyre bëhet sipas kriterit SMART (specifike, të matshëm, të arritshëm, të realizueshëm dhe të përcaktuar në kohë) për të qenë sa më operacionale.

### **Iniciuesi**

Institucioni/struktura/organizata/individit që merr përsiper fillimin e aksionit/aktivitetit/projektit të propozuar.

### **Zbatuesi**

Institucioni/struktura/organizata që do të sigurojë zbatimin/qëndrueshmërinë e nismës së propozuar. Këtu bëhet fjalë për aktorët që do të sigurojnë mirëadministrimin e nismës së propozuar, teksa përgjegjësia profesionale duhet të përcaktohet rast pas rasti dhe pas detajimit të mëtejshëm të secilës prej tyre.

### **Mbikqyrësi i zbatimit**

Institucioni/struktura/organizata që monitoron zbatimin e suksesshëm të nismës së propozuar. Mbikqyrja, në kuptimin e këtij plan-veprimi përfshin qoftë vetë institucionet publike, qoftë shoqërinë civile.

### **Afati i realizimit**

Caqet kohore benda së cilëve mund të realizohen propozimet, të ciltët mund të jenë: Afat Shkurtër (1-3 vjet), Afat Mesëm (4-6 vjet), Afat Gjatë (> 6 vjet).

### **Burimet e financimit**

Mundësitë e ndryshme të financimit të nismave të propozuara, si për shëmbull ente/grante shtetërore, donatorë e biznese vëndase dhe/apo të huaja. Kjo kolonë është bazuar në eksperiencat paraprake të pjesëmarrësve dhe hulumtimet e mëtejshme të CHwB-së.



## NJË PLAN-VEPRIM PËR SPAÇIN

### Objektivi 1. Edukimi, interpretimi dhe përfshirja publike

- 1.1 Ngritje e ndërgjegjësimit dhe edukim i komunitetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar rreth historisë së vuajtjeve dhe rezistencës së ish të burgosurve në Spaç.
- 1.2 Interpretim i vendit në mënyrë që çdo individ të kuptojë vlerën e Spaçit dhe të japë kontributin për ruajtjen dhe promovimin.
- 1.3 Bashkëpunim në shkallë të gjerë për të arritur përfshirjen dhe integrimin e ish të burgosurve dhe grupeve të përjashtuara.
- 1.4 Inkurajim për aktivizëm dhe përfshirje nga të gjithë vizitorët, veçanërisht brezat e rinj, drejt përmirësimit të shoqërisë.

Aksioni / Aktiviteti / Projekti	Iniciuesi	Zbatuesi	Mbikqyrësi i zbatimit	Afati i realizimit	Burimet e financimit
<p><b>1A. Përfshirja e historisë së ish-burgut të Spaçit në tekstet shkollore</b> Trajtimi më i plotë i historisë së regjimit komunist në tekstet shkollore, duke nisur nga shkolla fillore. Një fokus të veçantë për vendet e persekutimit, prej të cilëve shembulli i Spaçit mund të trajtohet më gjerësisht.</p>	IIPP, OJF <sup>1</sup>	MAS, ASHSH	MAS	Afat shkurtër	MAS, KAS, FES, QSHRT
<p><b>1B. Organizimi sistematik i ekskursioneve shkollore në ish-burgun e Spaçit</b> Në mbështetje të shtjellimit teorik të fenomenit të persekutimit politik në Shqipëri dhe për të ofruar përvojë të drejtpërdrejtë të vendeve të persekutimit, organizohen ekskursione në ish-burgun e Spaçit me shkollat e mesme.<sup>2</sup></p>	IIPP, OJF	MAS, Muzeumi i Burgut të Spaçit (OJF)	MAS	Afat mesëm	MAS, Muzeumi i Burgut të Spaçit (OJF), MKS
<p><b>1C. Krijimi i një baze të dhënash dixhitale për ish-burgun e Spaçit</b> Grumbullimi, përpunimi, dhe vënia në dispozicion për publikun dhe palët e interesit të një baze të dhënash ku të dokumentohet vazhdimisht kujtesa historike e ish burgut të Spaçit (intervista, ditare, piktura, foto, etj).</p>	IIPP, OJF, ISKK	OJF, ISKK	IIPP	Afat shkurtër	ISKK, KAS, HSS

<sup>1</sup> Për listën e plotë të akronimeve, shikoni faqjen 29..

<sup>2</sup> Ky sugjerim mbështetet dhe në rekomandimet e përgjithshme e përmajtura në "(post)Komunizmi në tekstet shkollore, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, 2007,f/17.f"



<b>Aksioni / Aktiviteti / Projekti</b>	<b>Iniciuesi</b>	<b>Zbatuesi</b>	<b>Mbikqyrësi i zbatimit</b>	<b>Afati i realizimit</b>	<b>Burimet e financimit</b>
<p><b>1D. Pajisja e ish-burgut të Spaçit me panele shpjeguese/interpretuese</b>            Panelet shpjeguese/interpretuese realizohen mbi bazën e dokumentacionit ekzistues dhe dëshmime të ish të burogosurve. Panelet shoqërojnë vizitorët në itineraret e ndryshme brenda e rreth ish-burgut të Spaçit.</p>	IIPP, OJF	ASHSH, OJF	ASHSH, MK, Komuna Orosh <sup>3</sup>	Afat shkurtër	MK, Komuna Orosh, ICSC
<p><b>1E. Krijimi i një webfaqeje zyrtare të ish-burgut të Spaçit</b>            Webfaqja ndërtohet në përputhje dhe me bazën e të dhënave (pika 1c) dhe në gjuhë të ndryshme. Informacioni që përmban përdoret dhe për realizimin e broshurave, aplikacioneve për smartfone, etj në shërbim të njohjes së historisë së ish-burgut të Spaçit.</p>	MK, Struktura menaxhuese e muzeut të ardhshëm	OJF, ISKK	IIPP, MK	Afat mesëm	MMSR, MK, ICSC, LERDA, Fondacioni Vodafone
<p><b>1F. Realizimi një fushate ndërgjegjësimi për çështjen e ruatjes së ish-burgut të Spaçit</b>            Konceptimi dhe zbatimi i një strategjie të koordinuar komunikimi, informimi dhe përfshirjeje të publikut të gjerë përmes përdorimit të medimeve të ndryshme (TV, Radio, Shtypi online dhe i shkruar).</p>	OJF, IIPP	DGK-UT	IIPP, ISKK	Afat shkurtër	KAS, Ambasada Holandeze
<p><b>1G. Promovimi me qëllim përfshirjen e ish-burgut të Spaçit në itineraret/paketat turistike ekzistuese</b>            Lobimi i drejtpërdrejtë tek operatorët turistikë publikë/privatë për përfshirjen e ish-burgut të Spaçit në ofertat e tyre turistike. Ish-burgu i Spaçit paraqitet dhe si një pikënisje për vizita të mëtejshme në Mirditë.</p>	Muzeumi i Burgut të Spaçit (OJF), IIPP	AKT, MZHUT, ATA	MZHUT, MK	Afat mesëm	AKT, MZHUT, USAID, GIZ

<sup>3</sup> Emërtimi i saktë i njësisë vendore do të jetë në përputhje me ndryshimet në kuadër të Reformës Administrative Territoriale gjatë viteve 2014-2015.

Aksioni / Aktiviteti / Projekti	Iniciuesi	Zbatuesi	Mbikqyrësi i zbatimit	Afati i realizimit	Burimet e financimit
<p><b>1H. Përcaktimi i një kalendari vjetor aktivitetesh publike që do të mbahen në ambjentet e ish-burgut të Spaçit</b></p> <p>Kalendari përcakton aktivitetet e ndryshme përkujtimore, edukativo-kulturore dhe artistike që zhvillohen në Spaç. Aktivitetet janë të lidhura me tematikat e persekutimit dhe qëndresës ndaj saj, demokracisë, të drejtat e njeriut, etj. Qëllimi i kalendarit është rritja e numrit të vizitorëve në Spaç dhe përreth.</p>	OJF, IIPP	Komuna Orosh, MK, ISKK	MK, IIPP	Afat shkurtër	MK, MMSR, IIKT
<p><b>1I. Trajnimi i ciceronëve për ish-burgun e Spaçit</b></p> <p>Zhvillimi i një programi trajnimi nga ekspertë për ciceronët që shoqërojnë individë, grupe të ndryshme në ish-burgun e Spaçit. Ciceronët do të jenë banorë vendas ose/dhe ish të burgosur të Spaçit.</p>	OJF, Komuna Orosh	OJF, ISKK	MZHUT, Komuna Orosh, IIPP	Afat shkurtër	MZHUT, AKT, ICSC
<p><b>1J. Realizimi i një publikimi për ish-burgun e Spaçit në gjininë e novelave grafike <sup>4</sup></b></p> <p>Publikimi i kushtohet njohjes së historisë së burgut të Spaçit nga të gjitha moshat, por veçanërisht nga të rinjtë, nëpërmjet teksteve të bashkëprodhuara me ish të dënuar politikë në Spaç dhe grafikave tërheqëse.</p>	CHwB, IIPP	CHwB, ISSK, OJF	IIPP, MK	Afat shkurtër	MK, Ambasada Suedeze / Franceze

<sup>4</sup> Propozim i shtuar nga CHwB, pas përfundimit të punëtorisë.

## Objektivi 2. Ndërtesat dhe infrastruktura

2.1. Rindërtim/konservim i ndërtesave ekzistuese (duke u përqëndruar fillimisht në pjesë të veçanta, si p.sh. kullat e vrojtimit, galerite e minierave) duke u bazuar në materiale e dokumenta të kohës.

2.2 Krijim i mundësive për rrugë alternative për hyrjen dhe përjetimin e ish burgut.

2.3 Ndërtim dhe përmirësim i vazhdueshëm i infrastrukturës dhe strukturave ndihmëse për të lehtësuar nevojat e vizitorëve in situ dhe në Reps.

Aksioni / Aktiviteti / Projekti	Iniciuesi	Zbatuesi	Mbikqyrësi i zbatimit	Afati i realizimit	Burimet e financimit
<p><b>2A. Rilevimi topografik dhe krijimi i hartës së plotë të ish-burgut të Spaçit</b></p> <p>Rilevimi i gjëndjes aktuale dhe dokumentimi grafik, fotografik duke u mbështetur në dokumenta ekzistuese. Kjo do të shërbejë për të kuptuar me mirë ndryshimin që ka pësuar ish - burgu dhe mundësitë që ka në këtë moment për përdorimin e hapësirave të mbetura.</p>	CHwB, Komuna Orosh	CHwB, Komuna Orosh	MK	Afat shkurtër	CHwB, MK, U Politeknik, U Epoka, U Polis, Komuna Orosh
<p><b>2B. Përgatitja e një maketi studimor/informues</b></p> <p>Një maket i gjendjes aktuale, shoqëruar me shpjegime e orientime, për gjithë zonën e ish-burgut do të ndërtohet për tu ekspozuar fillimisht në Muzeun Historik Kombëtar. Ky maket do të shërbejë për të kuptuar fizikisht terrenin, gjendjen dhe nevojat e ish-burgut nga publiku i gjerë.</p>	OJF	MK, ISKK	MK	Afat shkurtër	MK, OJF, MHK, U Politeknik, U Epoka, U Polis
<p><b>2C. Meremetim, stabilizim dhe ndriçim i rrugës Reps – Spaç</b></p> <p>Ndërhyrje stabilizuese të nevojshme në rrugën që çon nga dalja e rrugës kombëtare në ish-burgun e Spaçit, për të bërë të sigurtë transportin e vizitorëve. Nevojat parësore për rrugën janë: sigurimi nga rrëshqitjet e tokës, vendosja e barrierave anësore dhe krijimi i kanalizimit anësor për kullim.</p>	Komuna Orosh	Komuna Orosh	Komuna Orosh	Afat shkurtër	MZHUT– FZHR, FSHZH

Aksioni / Aktiviteti / Projekti	Iniciuesi	Zbatuesi	Mbikqyrësi i zbatimit	Afati i realizimit	Burimet e financimit
<p><b>2D. Izolim i tarracave dhe rregulim i sistemit drenazhues</b> Për shmangien e degradimit të mëtejshëm të godinave që i kanë mbijetuar shkatërrimit është e nevojshme të kryhet izolimi i tarracave, ndërhyrje në sistemin të kullimit të ujit dhe drenazhimit.</p>	OJF, IMK	IMK	MK	Afat shkurtër	PCF, MK
<p><b>2E. Rindërtimi i disa elementeve të rëndësishëm të ish-burgut të Spaçit</b> Bazuar në dëshmitë e ish të burgosurve dhe dokumenta (foto, përshkrime etj) do të bëhet rindërtimi i disa elementëve me domethënës të ish-burgut që janë shkatërruar, si psh: dera hyrëse, telat me gjëmba, një ose disa nga dhomat, kullat e vrojtimit (pikat e karakollit) etj, që do të ndihmojnë të kuptuarit dhe të përjetuarit të jetës në ish-burgun e Spaçit për vizitorët.</p>	OJF, IMK	OJF, IMK	MK, IMK	Afat mesëm	Ambasada Suedeze, AFCP
<p><b>2F. Krijimi i itinerarit bazë për vizitorët</b> Hartimi dhe krijimi i një itinerari fillestar për vizitorët shkon paralel me rindërtimin e disa elementëve të përmendur në pikën 2E. Itinerari do të ndjekë pikat më me interes bazuar në dëshmitë e ish të burgosurve dhe në dokumentacionin ekzistues.</p>	OJF, IIPP	MK, OJF	MK	Afat mesëm	MK, GIZ
<p><b>2G. Pastrim i integruar me ndërhyrjet restauruese i godinave dhe territorit në ish-burgun e Spaçit</b> Heqja e mbeturinave të ndryshme të shkaktuara nga shkatërrimi i godinave, aty ku është e nevojshme dhe e mundshme, nën mbikqyrjen e vazhdueshme të specialistëve restauratorë, në mënyrë që të mos humbin apo shkatërrohen materiale të vlefshme apo dëshmi që do të ndihmojnë në rindërtimin e objekteve apo ngjarjeve.</p>	Komuna Orosh, OJF	Komuna Orosh, MMSR	IMK, OJF	Afat shkurtër	MMSR, Komuna Orosh

Aksioni / Aktiviteti / Projekti	Iniciuesi	Zbatuesi	Mbikqyrësi i zbatimit	Afati i realizimit	Burimet e financimit
<p><b>2H. Krijimi i një pike informacioni</b> Ndërtimi i një objekti me funksion informimin dhe orientimin e vizitorëve për në ish burgun e Spaçit që do të vendoset në dalje të rrugës kombëtare. Aty do të vendoset një pjesë e stafit (banorë vendas) që do ti shërbejë strukturës së re të muzeut ku do të blihen biletat, merret informacion paraprak për itineraret e ndryshme dhe transportin.</p>	OJF, Komuna Orosh	MZHUT, Komuna Orosh	MZHUT	Afat shkurtër	Komuna Orosh, MZHUT, GIZ
<p><b>2I. Krijimi i një itinerari për turizmin malor rreth Spaçit</b> Duke vlerësuar veçantinë natyrore që ofron rruga që të çon në ish-burgun e Spaçit dhe zona përreth do të krijohet dhe një itinerar paralel alpin/natror për turistët që duan ta vizitojnë dhe pasuritë natyrore të shumta në zonë.</p>	Komuna Orosh	Komuna Orosh, shoqatat shqiptare për alpinizëm (OJF), IKU	MZHUT, MAS	Afat mesëm	GIZ, shoqatat shqiptare për alpinizëm (OJF), IKU
<p><b>2J. Identifikimi i itinerareve alternative turistike</b> Vendodhja e ish-burgut ofron mundësi të ndryshme vizitueshmërie si p.sh. në galeritë e minierave. Një prej mundësive për ta vizituar atë është një tunel që lidh me galeritë që ndodhen brenda dhe përreth ish-burgut. Për këtë qëllim do të kryhet një studim paraprak.</p>	Komuna Orosh	MZHUT, IMK	MK, IA	Afat shkurtër	MZHUT, Komuna Orosh
<p><b>2K. Përcaktimi i termave të referencës dhe organizimi i një konkursi projektimi për ish-burgun e Spaçit</b> Shpallja e konkursit për restaurimin dhe muzealizimin bëhet pas realizimit të një studimi të hollësishëm (pika 3B) dhe përcaktimit të termave të referencës.</p>	MK, IIPP	MK, IMK	MK, IIPP	Afat shkurtër	MK

### Objektivi 3. Korniza ligjore, menaxhimi dhe përfaqset strategjike

3.1 Themelimi i një institucioni muze i nivelit më të lartë kombëtar, një Muze Kombëtar i Kujtesës – Spaç (MKKS).

3.2. Vendosja e rregullave ligjore të qarta përsa i përket krijimit, strukturimit dhe menaxhimit të MKKS.

3.3 Integrimi i MKKS në rrjetet dhe itineraret/vendet ndërkombëtare të kujtesës.

3.4 MKKS në rolin e një modeli në Shqipëri dhe në rajon për praktika përfshirëse dhe debate mbi çështje bashkëkohore dhe shumë të diskutuara.

3.5 MKKS shërben si një motor zhvillimi ekonomik, kulturor dhe shoqëror për Mirditën.

